



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:033837

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05679432

Ac.nr.4720/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi – kryetar i kolegjit, Nora Bllaca Dula dhe Lumni Sallauka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit-propozuesit të masës së përkohshme të sigurimit Y..... Sh..... nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D..... M..... nga Prishtina, Rruga “Agim Ramadani”, numër 36/7, kati 2, ndaj kundërshtarit të sigurimit B..... A..... nga Prishtina, Rruga “A..... R.....”, numër 36/1, me objekt të shqyrtimit kërkesë për lirim nga garancioni, duke vendosur sipas ankesës së propozuesit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.775/11, të datës 02.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa e paditësit-propozuesit Y.....Sh.....nga Prishtina, të ushtruara kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.775/11, të datës 02.02.2024.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar C.nr.775/11, të datës 02.02.2024, ka refuzuar kërkesën e propozuesit për lirim nga detyrimi për dhënien e garancionit në shumën prej 5,000.00 Euro.

Kundër këtij aktvendimi paditësi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës material, me propozim që të ndryshohet Aktvendimi i atakuar dhe të lirohet propozuesi nga pagesa e garancionit apo çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

I padturi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209, lidhur me nenin 186.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është e palejuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 21.08.2008, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur kërkesë-propozim, ndaj kundërshatrit të sigurimit, për lëshimin e masës së përkohshme të sigurimit.

Me Aktvendimin C.nr.775/11 të datës 19.05.2015, gjykata e shkallës së parë ka detyruar paditësin për deponimin e garancionit në emër të garancisë për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë.

Me datë 26.04.2023 paditësi-propoziuesi paraqet kërkesë pranë gjykatës së shkallës së parë për lirim nga pagesa e garancionit.

Më pastaj gjykata e shkallës së parë nxjerrë Aktvendimin e atakuar me të cilën refuzon kërkesën e propozuesit për lirim nga deponimi i garancionit në emër të caktimit të masës së sigurimit të kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar lejueshmërinë e ankesës të paraqitur kundër Aktvendimit C.nr.775/11, të datës 02.02.2024, e paraqitur nga e paditësi, ka gjetur se ankesa është e palejuar, pasi që aktvendimi i atakuar është vendim përmes së cilit drejtohet procedura kontestimore, përkatësisht nuk është vendim meritore përmes së cilës zgjidhet çështje kryesore kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse, që është lëshimi i masës së sigurimit të kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit në kuptim të rrethanave të paraqitura më lartë gjen se ankesa është e palejuar, pasi që me dispozitën e nenit 387.2 të LPK-së, përcaktohet se: *“Kundër aktvendimeve të dhëna gjatë përgatitjes së shqyrtimit kryesor që kanë të bëjnë me drejtimin e gjykimit nuk lejohet ankimi”*.

Në kuptim të dispozitës së sipërcituara gjykata e shkallës së dytë ka ardhur në përfundim se ankesa e paraqitura nga padiësi-propoziuesi është e palejuara, pasi që e njëjta ka ktvendimin e gjykatës së shkallës së parë përmes së cilit drejtohet procedura kontestimore dhe jo zgjidhja e çështjes kryesore në mënyrë meritore të palës propozuese, andaj konform nenit 186.1 të LPK-së, ka vendosur që të hedhë poshtë si të palejuar ankesën.

Nga të lartëcekurat Gjykata e Apelit në pajtim të dispozitave nga neni 186 paragrafi 1, lidhur me nenin 209 pika a) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.4720/2024, datë 10.05.2024

Kryetari i kolegjit,  
Ardian Ajvazi